



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORTITETI KONTRAKTOR

BASHKIA BULQIZE

Nr _____ prot

Bulqize më, ____ .09.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje karburant (nafte), Bashkia Bulqize

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV): **09134000-7**

VLERA E FONDIT LIMIT: 7 560 833 (shtate milion e peseqind e gjashtedhjetë mijë e teteqind e tridhjetë e tre) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Bulqize hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a .Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në të cilin citohet: Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme për kualifikim shtojca 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit” të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së Fondit Limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “**3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës**”, nenin 43 “**Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare**” pika 2/c ku përcaktohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar

nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme” si dhe nenin 55 **“Procedurë e hapur e thjeshtuar”** pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Ne nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare si dhe në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 **“Për tatimin mbi të ardhurat”**, të ndryshuar ku përcaktohet se: **“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”**.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 si dhe këstin përkatës për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoritetet përkatëse sipas adresave të regjistruar në QKB.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Shënim : Referuar VKM-se nr 285, date 19.05.2021 **“Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” neni 26/6**

Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Kriteri për piken 2.2.2 konsiderohet i permbyshur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 **“Për Prokurimin Publik”**, ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 **“Për Sistemin e Taksave Vendore”** (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Bulqize, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka

kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

(Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) citohet:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesës vetë legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 **“Kërkesat për kualifikim”**, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** të ndryshuar në të cilin gjejmë të përcaktuar se: **“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” si dhe nenit 55 **“Procedurë e hapur e thjeshtuar”**, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”**, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40 **“Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”**, pika 4 të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, duke qenë se vlera e fondit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me “Licencë” (Të lëshuar nga Autoriteti Përkatës Licencues), për stacionin e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikantë dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas Ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999, **“Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”** i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 970, datë 02.12.2015 **“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”** i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 344, datë 19.04.2017 **“Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në Nr. 970, datë 02.12.2015.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40 , pika 5/a, ,të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku citohet:

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose... Ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 970, datë 02.12.2015 “**Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj**” i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në Nr. 970, datë 02.12.2015.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 pikë furnizimi të tregëtimit të karburantit në territorin e Bashkisë Bulqize e pasqyruar kjo tek të dhënat në QKR dhe e pasqyruar me Niptet (Adresat) Sekondare, shoqeruar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil kontrate qeraje ose akt pronësie

Argumentim: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,si dhe nenit 40, pika 5/ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.* Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën. Realizimi i kësaj kontrate ka për qëllim furnizimin me karburant të Bashkisë Bulqize ku përfshihen mjetet e Policisë Bashkiake, IMT, Njësi Administrative, Drejtorive të institucionit etj, ndaj është menduar që operatori ekonomik të ketë të paktën 1 pike furnizimi brenda territorit të Bashkisë Bulqize (pika të furnizimit me karburant), për të cilat duhet të disponojë edhe dokumentacionin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), i cili vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar dhe nuk ka pasur penalitete në lidhje me cilësinë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nenit 40,pika 6, germa c)*dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë*

pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Si dhe VKM Nr.147, datë 21.3.2007 për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel.

Vendosja e këtij kriteri është bërë duke pasur në konsideratë parashikimet ligjore të ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, ligji nr.32/ 2016 datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve/instalimeve nën presion” si dhe VKM nr.212, datë 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)” dhe ligji nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, i ndryshuar.

2.3.5.Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër që të furnizojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktor për kete të paraqitet deklarata që garanton dhe është i disponueshëm për furnizimin 24/24 për 7 ditë javës..

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kjo pike e vendosur nga AK i shërben Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik të jete i disponueshëm në çdo ditë/ore për furnizimin me karburant të mjeteve.

2.3.6.Referuar VKM-se Nr 561 date 29.07.2016“Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6 të nenit 40, dhe pikën 6 të nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku AK për plotësimin e kërkesave minimale të përcaktuara në DST mund të kërkojë fotografi apo katalogë teknik.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje dhe në zbatim me VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Kërkesa për disponimin e një website të furnitorit është e rëndësishme pasi furnizimi i karburantit me kartë elektronike, transferimi i sasisë së karburantit nga furnitor tek AK-ja bëhet në menyrë elektronike, vetëm nëpërmjet web-site.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet janë sipas standartin S SH EN 590:2022, të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Njesia e Prokurimit